



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritim Evropian

Mbledhja nr. 13.

Prishtinë, më 14.02.2018, në orën 10:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku, Fitore Pacolli dhe Adem Hoxha.

Munguan: Milaim Zeka dhe Glauk Konjufca .

Nga Staffi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ-i, OSBE-ja, NDI-ja, KDI-ja, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Armend Zemaj, zëvendëskryetar i parë i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 30.1.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-014 për infrastrukturën kritike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-214, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 30.1.2018;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 30.1.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Armend Zemaj, zëvendëskryetar, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor. Ky Projektligj përmban gjithsej 270 nene dhe 26 amendamente të Komisionit Funkcional dhe

është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2012/30/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 25 tetor 2012, për bashkërendimin e masave mbrojtëse, të cilat kërkohen, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, nga shtetet anëtare të kompanive, në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 54 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe sa i përket formimit të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me pikëpamjen që këto masa mbrojtëse të bëhen të barasvlershme;

Projektligji Nr. 05/6-016 për Shoqëritë Tregtare me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, janë shqyrtuar dhe është konstatuar se ky Projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Fatmire Kollçaku, tha se ne nuk kemi informata se me cilat direktiva të BE-së përafrohet ky Projektligj, andaj do të abstenoj .

Kryesuesi pas votimit, konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Armend Zemaj, në lidhje me këtë Projektligj, paraqiti opinionin ligjor, çështjet e rregulluara dhe të adresuara në Projektligjin nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike, në nivel të BE-së janë të rregulluara me Direktiva e Këshillit 2008/114/KE të datës 8 dhjetor 2008, mbi identifikimin dhe caktimin e infrastrukturës kritike Evropiane dhe vlerësimin e

nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre. Në kuadër të harmonizimit, zakonisht definicionet në legjislacionin e BE-së transpozohen fjalë për fjalë. Projektligji në nenin 3, ka bërë transpozimin e definicionit nga kjo Direktivë fjalë për fjalë, ndërsa, amendamenti 1 i Komisionit Funkcional bënë shmangie të pjesshme nga ky transpozim. Prandaj, me qëllim të transpozimit të plotë të këtij definicioni rekomandojmë që teksti i Nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11, të mbetet si në Projektligj.

Pas votimit, **kryesuesi** konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

- 1. Projektligji nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian;**
- 2. Amendamenti 1 i Komisioni Funkcional, nuk përkrahet nga Komisioni;**
- 3. Amendamentet e tjera të propozuara nga Komisioni Funkcional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.**

- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-214, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

Armend Zemaj, paraqiti opinionin ligjor për Projektligjin Nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-214, i cili tha, ka për qëllim transpozimin e Rregullores së BE-së (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 9 mars 2016, për krijimin e një Kodi të Unionit mbi rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufijve (Kodi i Kufijve Shengen).

Ky Projektligji përmban 12 nene dhe 5 amendamente të paraqitura nga Komisioni Funkcional.

Pas shqyrtimit të Projektligjit Nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-214, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, konstatojmë se dispozitat e këtij Projektligji nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe e njëjta është në përputhje me *Acquis* të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, **kryesuesi** konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Lidhur me këtë Projektligj, **zv.kryetari** paraqiti opinionin ligjor.

Projektligji Nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, rregullon të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat doganore për veprim nga Dogana e Kosovës për mallrat të cilat janë të dyshimta për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ky Projektligj përmban gjithsej 36 nene dhe 12 amendamente të Komisionit Funkcional.

Legjislacioni i BE-së i transpozuar në këtë projektligj është si më poshtë:

Rregullorja e BE Nr. 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 12 qershor 2013, lidhur me masat doganore për të drejtat e pronësisë intelektuale.

Projektligji Nr. 05/6-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, janë shqyrtuar dhe është konstatuar se ky Projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt Kuvend.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se me shumicë votash Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

7. Të ndryshme.

Ilir Deda, pyeti se a është iniciuar formimi i grupit punues për harmonizim të punës me Ministrinë e Integrimi Evropiane. Ne e kemi marr planin e tyre të punës dhe ne duhet ta bëjmë koordinimin e planit tonë me atë të tyre.

Blerta Deliu, tha se administrata po merret me çështjet teknike mes Ministrisë së Integrimi dhe Komisionit për Integrimi Evropiane. Propozoj që të formohet grupi punues në krye me deputetin Ilir Deda dhe të përfshihet niveli politik i anëtarëve si dhe ministrja, nëse pajtoheni.

Ahmet Isufi, tha se nëse formohet grupi punues, atëherë dikush nga administrata duhet ta bëjë koordinimin me ministrinë .

Armend Zemaj, tha se ne si komision me rolin mbikëqyrës parlamentar për agjendën evropiane, po e ulim nivelin politik me formimin e grupeve të përbashkëta punuese me ata që ne i mbikëqyrim dhe na raportojnë neve. Jam kundër në aspektin procedural, andaj nuk pajtohem sepse sa herë është e nevojshme mund ta thërrasim ministrin dhe ministrat tjerë të raportojnë për agjendën evropiane, sepse nëse lëshohemi në çështje

teknike, atëherë kjo është përzierje në kompetenca sepse ata kanë kompetenca ekzekutive të ndara prej neve.

Ilir Deda, shtoi se ne si Komision duhet ti realizojmë tetë vizita .

Blerta Deliu, tha se nuk ka ulje të nivelit parlamentar, nëse ka një grup koordinues mes politikave të Qeveris dhe politikave të Komisionit, çka nënkupton se ne duhet të jemi prezent me 5 shtetet që nuk na kanë njohur dhe me shtetet mike që kanë lëvizur me qëndrime karshi mbështetjes, procesi i zgjerimit e ka hap një kapitull të ri sa i përket agjendës evropiane të Kosovës dhe duhet shtuar praninë më të madhe të Komisionit në këtë proces.

Armend Zemaj, tha se është kundërshtar i dualizmave dhe institucionalizmave, ne kur e miratuar planin e punës të gjithë u pajtuam që të plotësohet plani punës sipas nevojës.

Fatmire Kollçaku, tha se ky komision duhet të jetë më aktiv sepse puna e deritanishme është më shumë teknike. Duhet të fuqizohet roli i këtij Komisioni sepse Komisioni për MSA-në disi si e ka marrë rolin prijës dhe Komisionit për Integrimet i është zbehur rëndësia dhe krejt këtë e kuptoj në kontekstin e fuqizimit të rolit të Komisionit.

Armend Zemaj: Atëherë, nëse pajtoheni, propozoj që të formohet grupi punues, në krye me Ilir Dedën, Fatmire Kollçakun dhe Ahmet Isufin dhe të takohen me ministren në Ministri të integrimi, të ulen së bashku dhe të punojnë.

Ilir Deda: Më mirë do të ishte që ne ta thërrasim ministren e Integrimi Evropian ne, në një takim të mbyllur të Komisionit, ku do të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit dhe të punojmë në agjendën e përbashkët.

Armend Zemaj, propozoi që kur të thirret ministrja në Komision, t'i adresojmë tri-katër pika dhe të dimë çka po kërkojmë dhe tha se e angazhon z. Deda si kryesues të grupit. Ministrja e ka agjendën evropiane, i ka datat e sakta dhe pastaj e shohim .

Zenun Pajaziti, theksoi se me Ministrinë e Integrimi, duhet të koordinohemi gjithsesi. Ne duhet ti shohim pikat ku kemi ngecje e që janë sfidat kryesore, duhet ti takojmë drejtpërdrejt agjencitë, ti shohim sfidat që në Raport të Progresit përsëriten, gjithnjë në bashkëpunim me Ministrinë e Integrimi.

Armend Zemaj, pas diskutimeve, konstatoi se Komisioni u pajtua që ta ftojë ministren e Integrimi Evropiane në një takim të mbyllur, me ç'rast bashkërisht do të punohet, të saktësohen datat e takimeve që janë në agjendën evropiane, duke përfshirë edhe ndihmën e partnerëve që ndihmojnë Komisionin dhe shoqërisë civile dhe me punë të përbashkët, përfundimet të përfshihen në planin e punës .

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit

Zëvendëskryetari i parë i Komisionit,
Armend Zemaj
